



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 5, datë 30. 03. 2009

**PËR**  
**“NJË NDRYSHIM NË VKB-NË NR. 78, DATË 27.12.2007 MBI**  
**“MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË APARATIT TË**  
**BASHKISË SË TIRANËS”**

Në mbështetje të neni 32, shkronja “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligji nr.8405, date 17.09.1998 për “Urbanistikën” (i ndryshuar); VKM-së nr.229, datë 23.4.2004 “Ceremoniali Zyrtar i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); VKB-së nr.78, datë 27.12.2007 për “Miratimin e strukturës organizative të Bashkisë së Tiranës” me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Struktura organizative dhe organograma e përcaktuar ne pikën 1 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.78, datë 27.12.2007 mbi “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës”, ndryshojnë sipas strukturës organizative dhe organogramës bashkëlidhur ,
2. Pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.78, datë 27.12.2007 mbi “Miratimin e strukturës organizative të aparatit të Bashkisë së Tiranës” ndryshon sipas përmbajtjes më poshtë:

**Numri i punonjësve të Bashkisë:**

- |  |     |
|--|-----|
| • Punonjës funksionarë dhë nëpunës civil | 385 |
| • Punonjës Shërbimi (me kontratë)        | 80  |
| • Inspektoriati Ndërtimor e Urbanistik   | 45  |

- Njësia e Menaxhimit të Projekteve

9

3. Të gjitha ndryshimet në strukturën organizative, do të përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2009.
4. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Planifikimit Strategjik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

**K R Y E T A R**